



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr. 8616 /2019
Data: 17.09.2019

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e tetë - VIII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 27.08.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Kujtim Dernjani (Përfaqësues i Komisionit të Aksionarëve të Kompanisë Pastrimi), Ajete Berisha (Udhëheqëse e Personelit), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Përfaqësuesit e OSB-së. Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i kuvendit të komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë për raportin e punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2019.
3. Shqyrtimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2020.
4. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Qershor 2019.
5. Miratimi i kërkesës për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.
6. Informatë mbi Qarkoren e dytë të brendshme buxhetore.
7. Informatë për suksesin e përgjithshëm të nxënësve për gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2018/2019.
8. Informatë mbi raportin e shpenzimeve për "Javën Kulturore" 2019.
9. Informatë për korrje shirjet.
10. Informatë mbi raportin financiar për gjashtëmujorin e N.P.L "Pastrimi" sh.
11. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:- shpeshherë e kam diskutuar çështjen e informatave por nuk është marr parasysh, e komuna është shëndrruar në shërbim informativ për shkak se prej njëmbëdhjetë pikave që janë paraparë me u diskutuar në këtë mbledhje gjashtë prej tyre janë informata dhe mendoj që jeni duke bërë shkelje ligjore sepse as në rregullore as në statut të komunës dhe në ligj të MAPL nuk shkruan që kuvendi informohet. Te raporti i kryetarit shënon raport, ndërsa në rend të punës paraqitet informatë. Besoj që keni kuadro që i dinë mirë këto punë duke filluar nga kryesuesi i kuvendit dhe juristë të tjerë, mirëpo po bëni shkelje ligjore. Nëse është çështja vetëm për informatë ne si asamblistë e kemi lexuar dhe nuk ka nevojë dikush që të raporton. Unë mendoj që gjashtë pikat të cilat janë informata me i hequr prej rendit të punës.

Kryesuesi thekson:- këto pika janë të përcaktuar në bazë të planit të punës së kuvendit të komunës që është miratuar në vitin 2018. Në muajin shtator miratohet plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2020 dhe për çështjen e informatave nëse kemi bazë ligjore mundemi me i ndryshuar. A keni edhe ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin,

Florim Shkreta thekson:- në faqe shtatë të plotësohet diskutimi dhe të jetë , kërkoj përgjigje me shkrim se si ka shkuar mënyra e përzgjedhjes së punëtorit më të mirë të Komunës së Hanit të Elezit. Kërkojë akt emërimit e gjithë atyre të cilët janë zgjedhur më të dalluar. Datën e fillimit të punës dhe kur janë shpallur më të dalluar prej momentit që ka filluar përzgjedhja e punëtorëve më të dalluar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Informatë për raportin e punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2019.

Mallzum Qajani thekson:- keni pranuar raportin gjashtëmujorë të punës së kryetarit të komunës që është një përshkrim i aktiviteteve të cilat e kanë përshkruar komunën gjatë këtij gjashtë mujori dhe aktivitetet në drejtoritë përkatëse. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- unë në fillim potencova që nuk është përshkrim i aktiviteteve por është theksim i aktiviteteve. Te aktivitete e kryetari të komunës pika shtatë që është shënuar zhvillim profesional, pjesëmarrje në trajnime të ndryshme të zyrtarëve komunal, personelit shëndetësor dhe mësimdhënësve. Edhe vitin e kaluar kam potencuar se termi zhvillim nuk e ka vendin këtu për shkak se kemi aftësim profesional. Te zyra e prokurimit është shënuar servisimi dhe mirëmbajtja e veturave te QKMF-se në shumë prej 4,343.00 € . Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave te Administratës, AD.Komunale-Ritenderim në shumë prej 9,555.40 €. A ka mundësi që këto me na i zbërthyer sa vetura janë servisuar, arsyen e prishjes, në qoftë se kanë bërë ndeshje si janë bërë për shkak se po që se mblidhen këto shifra afër 14000 € po bëhen dhe mendoj që është shpenzim i tepërt. Në të ardhmen kur të paraqiten duhet të specifikohen saktë.

Mehmet Ballazhi thekson:- në KPF kam parashtruar kërkesë që drejtori i kompanisë “Bifurkacioni” me ardhur me dhënë sqarime rreth çështjes së ujit. Është vlerësuar se transparenca në Han të Elezit nuk është e nivelit të duhur edhe se jeni munduar ndoshta me demantuar atë vlerësim. Po të shikohet raporti vërehet që ka shpenzime të tepërta çoftë në mirëmbajtje të automjeteve, në shpenzime komunale dhe të tjera por ajo që është jetike çështja e ujit nuk është shënuar asnjë gërmë dhe është dashur të jemi transparent dhe të potenconi që për çështje të ujit nuk e kemi bërë asnjë zgjidhje. Në plan të kryetarit nuk ka pasur edhe më herët por edhe në raport nuk është paraqitur për përpjekjet për zgjidhje të problemit të ujit qoftë të pishëm qoftë industrial për amvisëri për shkak se në Han të Elezit çështja e ujit është në mungesë dhe këtë periudhë që është nxehtë shumica edhe e anëtarëve të kuvendit kanë problem por edhe qytetarët, e është çudi që askush nuk e diskuton këtë. Në raport është dashur të cekën edhe këto probleme për shkak se është neglizhencë e madhe. Shpenzimet është dashur të shënohen në mënyrë më të detajuar në mënyrë se për çka bëhet fjalë dhe për çështje të ujit dhe ambientit nuk është shënuar asgjë.

Sabrije Krasniçi thekson:- isha e interesuar për transparencën dhe më është thënë që është e nivelit më të lartë prej gjitha komunave . Kërkoj sqarim se cilët janë faktorët të cilët e kanë bërë uljen e transparencës në komunën tonë? Javën pedagogjike që e kam bërë në shkollën “Kështjella e Diturisë” të gjithë nxënësit ujin e pijes e kanë marr prej shtëpisë dhe kanë potencuar që uji nuk është i pishëm në atë shkollë. Kam dëgjuar se në fshatin Seçishtë ka persona që më së shumti janë me diabet dhe a jeni interesuar se cila është arsyeja apo shkak se pse në atë fshatë është shfaqur më së shumti kjo sëmundje? Asfaltimi i rrugës Dermjak –Neqafcë nuk është bërë dhe tash jemi në fund të vitit dhe koha është e vjeshtës dhe dimër dhe besoj që nuk do të mund t’i zhvillojnë punimet kompanitë. Te rruga Ramuk-Kashan janë ndërprerë punimet dhe pse nuk keni vazhduar me bërë asfaltimin. Ka qenë një rast që policia në fshatin Paldenicë te dera e ka pritë traktori me dru dhe e ka ndaluar dhe kjo mund të sjellë probleme në atë familje për shkak se policia mund ta pritë me ndonjë vend të caktuar e jo para dera se i jep shqetësime familjes së atij personi. Pse është mbjell sipërfaqe e vogël e grurit dhe është dashur që me pasur sipërfaqe më të madhe të mbjellura me grurë?

Akif Shkreta thekson:- ne edhe më herët kemi kërkuar që në kuadër të objektivave të kryetarit të komunës të jenë dy çështje, njëra të jetë çështja e ujit dhe tjetra të jetë ndotja e ambientit për shkak se probleme më të theksuara që njihen në Han të Elezit janë këto dy çështje. Për këto dy çështje komuna duhet të jep maksimumin e mundshëm. Çfarë kompetenca ka komuna për ujin e pijes dhe çfarë kompetenca ka kompania “Bifurkacioni” për shkak se me një farë forme mos ta vendosim çështjen te kompania “Bifurkacioni” dhe kompania e potencon të kundërtën dhe nëse është kompetencë e komunës ne të mbetet e komunës sepse komuna e ka në plan çështjen e ujit të pijes?

Mehmet Ballazhi thekson:- çështja e kompetencave dihet çartë për shkak se i përcakton ligji dhe kërkesë kam parashtruar për drejtorin që të jetë prezentë në mënyrë që të njoftohemi si asamble komunale dhe ndoshta si asamble komunale kishim mundur me shtyrë problemin e zgjidhjes së çështjes së ujit për shkak se kompania e menaxhon ujin, kurse për çështje të ujësjellësit kompetencat i ka komuna dhe është çështje e komunës se si i bënë iniciativat. Duhet të raportohen punët që janë kryer por edhe punët të cilat nuk janë kryer për shkak se ne e dimë që me një institucion shënojnë më shumë ata që janë pozitive për institucionin por me gjithëatë si përfaqësues të qytetarëve duhet të jemi në dijeni për punët të cilat nuk janë kryer.

Akif Shkreta thekson:- si anëtarë i kuvendit të komunës më intereson të di se cilat janë kompetencat e komunës sa i përket ujit dhe cilat janë kompetencat e kompanisë “Bifurkacioni” për shkak se këto dy çështje dua mi ndarë dhe me i ditur?

Isni Bushi thekson:- Drejtori për Zhvillim Ekonomik ka potencuar që projekti “Empoëer” në përgjithësi kap vlerën rreth 29,500.00 € ku komuna ka participuar me 22% apo 7,000 €. Është potencuar që janë përfitues njëmbëdhjetë persona dhe në muajin korrik do t’i marrin pajisjet. Kërkoj sqarim se përfituesit e këtyre veprimtarie janë personat të cilët janë duke u marrur me atë biznes dhe tash e kanë zgjeruar apo janë persona të rinjë. A kanë filluar punën me këto veprimtari personat që janë përfitues të këtyre pajisjeve?

Nora Xhoni thekson:- për subvencione kanë aplikuar 75 fermerë në sektorë të ndryshëm dhe prej vitit 2018 ka një rënie për vitin 2019, mirëpo është mirë me gjetur ndonjë mënyrë për me i joshur fermerët në mënyrë që mos me pasur rënie.

Florim Shkreta thekson:- kërkoj sqarim për paramasat për ngritjen e lapidarit për pllakat përkujtimore të dëshmorëve. Kërkoj sqarim për marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Te Eksodi “Bllaca 99” kush përkujdeset për shkak se e kanë dëmtuar projektin që e kanë realizuar. Çfarë të mire i ka sjellë Hanit të Elezit takimin që e ka pas kryetari i komunës së Hanit të Elezit me kryetarin e komunës së Gazibabës? Sa vetura janë servisuar te QKMF-ja dhe të administratës komunale? Mirëmbajtja dhe ndriçimi publik në zonën urbane dhe rurale dhe për cilën zonë bëhet fjalë? Te Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport kërkoj sqarim për testin që është mbajtur për e kandidatët për lëndën e Historisë.

Mallzum Qajani thekson:- termi zhvillim profesional është një term që përdoret në të gjitha institucionet, e na si komunë e kemi përdorur dhe mendoj që nuk është ndonjë gabim që përdoret. Për shpenzimet për mirëmbajtje të automjeteve në QKMF dhe në Administratë komunale drejtoritë është dashur me i shënuar në mënyrë më detale dhe në të ardhmen do të mundohemi që të dhënat të janë më në detale. Ndërmarrja publike rajonale “Bifurkacioni” është përgjegjëse vetëm ndaj Qeverisë. Është shumë e vërtetë që ndër pikat më të rëndësishme në komunë është çështja e ujit dhe komuna nuk ka pasur diçka konkrete në këtë gjashtëmuajorë. Kemi themeluar njësinë për menaxhimin e ujit dhe kemi marrëveshje me CDI-në që të riaftësohet fabrika e ujësjellësit në Dermjak dhe procedurat e prokurimit të CDI-së janë vonuar aq shumë dhe nuk kemi pasur asnjë risi që në këtë gjashtëmuajor me shënuar për ujin, e për atë nuk kemi shënuar asgjë. Në zyrën e kryeministrit janë mbajtur tri takime për çështjen e ujit. Nuk kam njohuri që ndonjë institucion kompetentë ka vlerësuar që është ulur transparenca por edhe raporti i performancës nuk e vlerëson këtë. Diabeti nuk është prezentë veç në fshatin Seçishtë por në tërë komunën dhe si komunë nuk kemi ndonjë informatë zyrtare që në fshatin Seçishtë është më prezent. Rruga e fshatit Neqafçë do të rregullohet nga Ministria e Infrastrukturës, ndërsa për rrugën e Lagjes Ramuk nuk kam informacione që është ndaluar dhe ajo punë do të kryhet sipas planit dinamik të punës. Sa i përket policisë që para shtëpisë ia ka konfiskuar drutë, është çështje e policisë dhe ndoshta qytetari nuk ka qenë i pajisur me leje për prerjen e drunjve. Kompetencë e komunës është që me i furnizuar qytetarët me ujë dhe ne jemi

munduar që prurjet e ujësjellësit të funksionalizohet dhe për momentin në menaxhim është vetëm pjesa e ujit të Glloboçicës. Nëse CDI-ja e rehabiliton ujësjellësin atëherë në mënyrë graduale do të futet në menaxhim edhe Hani i Elezit. Në bazë të qarkores buxhetore kemi një limit se sa mjete financiare mund t'i japim subvencione dhe kemi dhënë edhe për mbjellje të grurit por qytetarët nuk po mbjellin për shkak se ndoshta nuk kanë leverdi. Projekti "Ekzodi 99" që është rregulluar është i Qeverisë për me u interesuar për sigurinë e atij projekti që e ka rregulluar . Sa i përket projektit për rregullimin e lapidareve për dëshmorët shifrat mund t'i shihni te zyra e prokurimit. Me komunën e Gazibabës kemi një marrëveshje për të qenë pjesë e një projekti IPA që është i Bashkësisë Evropiane të cilin e kemi kaluar fazën e parë dhe jemi në prag për me kaluar edhe fazën e dytë. Mirëmbajtja e ndriçimit publik është për tërë territorin e Hanit të Elezit dhe në këtë vit do të ndriçohet një pjesë e Lagjes së Re. Komuna nuk e furnizon me ujë fshatin Paldenicë dhe furnizimi që bëhet për shkollë është privat dhe për herë të parë po dëgjoj që ai ujë nuk pihet.

Menduh Vlasi thekson:- është shpallur konkursi për lëndën e Historisë dhe në fillim e kemi shpallur me afat të caktuar për arsye se jam konsultuar me telefon me zyrтарin ligjorë të Ministrisë së Arsimit i cili ka potencuar që duhet t'i ruhet vendi i punës drejtorit të shkollës. Më vonë kur e kam shpallur konkursin dhe kandidatët të cilët nuk kanë fituar pikë të mjaftueshme janë ankuar dhe inspektorët e punës kanë kërkuar që me rishpallur përsëri konkursin. Konkursi është shpallur dhe komisioni e ka kryer punën e vet konform rregulloreve dhe ligjeve.

Florim Shkreta thekson:- me çfarë udhëzime administrative keni punuar që e keni shpallur dy herë konkursin dhe ke premtuar që do të jesh i sinqertë por në këtë rast nuk je i sinqertë?

Menduh Vlasi thekson:- konkursi është shpallur në bazë të udhëzimeve administrative të Ministrisë së Arsimit dhe të Qeverisë së Kosovës dhe janë organet përkatëse që e përcaktojnë .

Zaim Bela thekson:- jam i njoftuar për rastin e policisë që ka ndodhë në fshatin Paldenicë por ata i kanë punët në bazë të planit dhe nuk na raportojnë neve. Subvencione japim edhe komunale por edhe direkte që jep ministria dhe për subvencionet direkte vetëm i zhvillojmë procedurat.

Kujtim Dernjani thekson:- sa i përket ndriçimit publik në zonat urbane dhe rurale bëhet fjalë për mirëmbajtjen e ndriçimit publik në tërë territorin e komunës së Hanit të Elezit.

Mefail Suma thekson:- te prokurimi shënon data e shpalljes së fituesit shuma e projektuar dhe shuma e planifikuar dhe po planifikohen 3000 € kurse kontrata lidhet në shumë prej 1900 € që do të thotë që planifikimi nuk bëhet mirë. Nëse bëhen fjalë për kontratë një vjeçare pse e keni shënuar në raportin gjashtëmuajorë por është mirë me i ndarë raportet. Sa i përket mbjelljes së grurit unë jam fshatarë dhe merrem me bujqësi por kohët e fundit derrat e egër janë duke dëmtuar çdo gjë. Edhe nëse mbjellim plehun artificial të cilin e blejmë nuk është kualitet. Për ujësjellësin e rekës së Dimcës janë shpenzuar 500 000.00 € dhe një javë ka qenë në media që kryetari i komunës e siguroi ujin, mirëpo është mirë me deklaruar në media për projektet të cilat nuk janë kryer. Fshati Dimcë ujin nuk e përdorë për ujitje, kurse fshati Dermjak nuk na lenë me shfrytëzuar ujin as juve si komunë dhe as fshatin Dimcë, e që komuna as që e ka shqyrtuar këtë çështje.

Mehmet Ballazhi thekson:- edhe më herët e kam diskutuar çështjen e menaxhimit të ujit dhe nënkryetari i komunës ka potencuar që ujë ka tepër por vetëm duhet të menaxhohet dhe gjashtë muaj ujë nuk ka hiq që do të thotë se planifikimi i juaj është i keq apo parashikimet tua janë keq apo menaxhimi është i keq. Gjërat po merren shkel e shko në mënyrë që me potencuar në kuvend që ky është menaxhimi jonë fundi fundit bëni çka të doni. Ne po mundohemi me i sqaruar çështjet, me i ngritë çështjet dhe me gjetur zgjidhje e jo vetëm me kaluar si formalizëm.

Florim Shkreta thekson:- çështja e ndriçimit publik nuk përcaktohet se në cilën zonë për shkak se në fshatin Seçishtë afër 30 ditë i ka që ndriçimi publik nuk është në rregull. Si e ka të rregulluar kontratën kompania për çështjen e ndriçimit publik . Për projektin për vendosjen e pllakave përkujtimore mendoj që është bërë punë më shumë ndërsa planifikimet janë më pak.

Sabrije Krasniçi thekson:- është mirë që komuna me u interesuar për çështjen të cilën e ngrita për fshatin Seçishtë dhe nëse është e vërtetë duhet të dihet se cila është arsyeja. Unë nuk potencova që policia mos me dalë në fshatin Paldenicë por policia duhet të merret me sigurimin e banorëve e jo mi shqetësuar banorët.

Kujtim Dernjani thekson:- nëse potencohet ndriçimi publik në zonën urbane nënkuptohet për Hanin e Elezit dhe nëse potencohet zona rurale përfshihen të gjitha vendbanimet. Për fshatin Seçishtë i kemi të identifikuar dritat të cilat nuk janë funksionale dhe ia kemi përcjellë kompanisë për me i rregulluar.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Shqyrtimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- rregullorja në fjalë për çdo vit rishqyrtohet dhe miratohet në kuvend. Ndryshimi i parë i kësaj rregullore të cilën e kemi pasur më përpara është në emërtim dhe ky emërtim është dërguar prej Kolegjiumit të Zyrtarëve Ligjorë të Asociacionit të Komunave. Ndryshimet i keni për secilën veprimtari dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo propozim mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- rregullorja nuk ka shkresë përcjellëse që është drejtuar në KPF apo në kuvend dhe ka gabime drejt shkrimore shumë dhe në fillim është shënuar që me këtë rregullore përcaktohen lartësia. Duhet të përmirësohet. Ngjyrat nuk janë sqaruar se çka nënkuptohet.

Sabrije Krasniçi thekson:- unë mendoj që komuna duhet ta bënë zbritjen e taksave për qytetarët

Florim Shkreta thekson:- për çështjen e taksës së bankave është mirë me shqyrtuar se ndoshta mos është shkas taksa dhe bankat po tërhiqen prej Hanit të Elezit

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 11 për 1 abstenim.

U VOTUA RREGULLORJA PËR TAKSA KOMUNALE PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK

4. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Qershor 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- të hyrat vetanake për këtë periudhë gjashtëmujore 2019 janë realizuar në shumë prej 169,938,08 € apo për 7,849.64 € më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Shpenzimi për këtë periudhë gjashtëmujore 2019 është realizuar në shumë prej 1,116,661.19 Euro apo për 219,422.79 € më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Çdo tabelë i ka shpjegimet e veta dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Florim Shkreta thekson:- pagat dhe mëditjet janë shpenzuar 732,417.71 € në gjashtëmujorin e parë të viti 2019 dhe nëse shkohet edhe në gjashtë mujorin e dytë teprojnë një pjesë e mjeteve financiare. Furnizim me ushqim dhe pije shuma e mjeteve 1197.00 € teprojnë.

Shabi Rexhallari thekson:- te pagat është ky shpenzim dhe e dimë që në muajin dhjetor do të bëhet ngritja e pagave dhe do ta mbulojnë atë pjesë, po ashtu ende nuk janë paguar pagat përcjellëse për punëtorët të cilët dalin në pension. Diferenca për furnizim me ushqim dhe pije janë në dhuratat të cilat nuk i kemi paguar në vitin e kaluar dhe koktelle të tjera të cilat janë furnizuar.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri .

U MIRATUA RAPORTI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2019

5. Miratimi i kërkesës për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- rishikim të buxhetit në këtë vit nuk ka dhe në bazë të ligjit është e nevojshme rialokimi i mjeteve të bëhet për shkak të nevojave të komunës. Rialokimi dhe transferi në total është në shumë prej 293,726.56 € nga fondet 10, 21 në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale sipas tabelave 4.1 dhe 4.2 të bashkangjitur këtij vendimi. Materialin të cilin e kemi dërguar i kemi dhënë sqarimet në detale dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Hanumshahe Dibrani thekson:- të vendosen edhe pushimore për këmbësorë në trotuarin për këmbësorë Hani i Elezit-Uji Thart.

Akif Shkreta thekson:- a është i gatshëm projekti për rregullimin e shtratit të lumit Lepenc dhe a e plotëson kjo shumë këtë projekt dhe a bien në shpërputhje me projektin që e ka pasur Ministria?

Shabi Rexhallari thekson:- projekti në fjalë vazhdon viteve të tjera dhe në këtë vit nuk fillon dhe këto mjete transferohen në projekte të tjera.

Mallzum Qajani thekson:- është e vërtetë që ekziston një projekt prej Ministrisë së Ambientit për rregullimin e një pjese të shtratit të lumit Lepenc por nuk është i plotë për shkak se nuk është deri te Ura e Fezës. Ne po mendojmë me zgjeruar këtë dhe është një prej pikave që banka botërore e ka investuar që duhet të investohet për shkak se kemi marr pjesë në takimet për këtë çështje.

U MIRATUA KËRKESA PËR RIALOKIM DHE TRANSFER TË MJETEVE NË KATEGORINË EKONOMIKE SHPENZIME KAPITALE

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 12 anëtarë të kuvendit të komunës).

U MIRATUA PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË 2019-2023

6. Informatë mbi Qarkoren e dytë të brendshme buxhetore.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7. Informatë për suksesin e përgjithshëm të nxënësve për gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2018/2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson:- jemi munduar në mënyrë shumë të qartë me i paraqitur të gjitha të arriturat dhe dobësitë të arsimit që i kemi pasur gjatë vitit 2018/2019. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- kjo pikë e rendit të punës për vitet e tjera kam dëshirë të jetë raport. Tabela numër gjashtë gjysmëvjetori i dytë orët e pa mbajtura në shkollën fillore “Ilaz Thaçi” gjithsejtë janë 1431. Kërkojë sqarim ta dijë se a është çështja e bojkotit apo janë mungesa dhe nëse është çështje e bojkotit kuptohet por nëse është mungesa e nxënësve i bien që katër dytë e gjysmë brenda gjysmëvjetorit të dytë nuk është punuar. E njëjta pyetje është edhe për shkollën e mesme “Dardania” sepse edhe në atë shkollë janë gati katër ditë. Orët e humbura nuk e di a i keni mbajtur, kurse orë plotësuese nuk kam vërejt që keni mbajtur. Për personelin arsimorë asnjë fjali nuk është shënuar. Si është gjendja momentale e objekteve për shkak se nuk keni dhënë informacion dhe pse nuk janë paraqitur mungesat e personelit?

Akif Shkreta thekson:- po afrohet shtatori dhe po fillon viti i ri shkollorë dhe nga e kaluara ka pasur ç’kyqje të komunës sonë në projekte sa i përket të zhvillimit të ngritjes së kapaciteteve të zhvillimeve profesionale të mësimdhënësve. Duhet të jemi më shumë aktiv me Ministrinë e Arsimit dhe një pjesë e shumë projekteve të cilat zhvillohen në nivel të shtetit dhe a jeni i informuar që në disa komuna të Kosovës është pilot projekti për mësim gjithë ditore për shkollat të cilat i plotësojnë kushtet dhe a mund të ndodhë kjo edhe në komunën tonë duke u bazuar që dy shkolla fillore dhe shkolla e mesme i plotësojnë kushtet për mësim gjithëditore.

Sabrije Krasniqi thekson:- kemi biseduar edhe për fshatin Seçishtë që ka pak nxënës në atë shkollë dhe a keni informacione se pse nxënësit nuk shkojnë në atë shkollë, a është shkak i shkollës që nuk është e riparueshme apo shkak i mësimdhënësve, cila është arsyeja? Kam vërejtur që edhe në fshatin Paldenicë është tu ndodhë e njëjta se te parafillorët janë vetëm 12 nxënës.

Samire Curri thekson:- si drejtori a jeni të kënaqur me suksesin e nxënësve në përgjithësi në krahasim me vitin e kaluar?

Isni Bushi thekson:- tabela numër pesë orët e pa mbajtura e dimë që në gjysmëvjetorin e dytë ka qenë greva e mësimdhënësve afër tri javë dhe komuna e Hanit të Elezit dy javë i ka zëvendësuar. Numri i orëve të pa mbajtura është rritur te shkolla fillore “Ilaz Thaçi”. Vërehet te shkolla “Kështjella e Diturisë” dhe te shkolla “Veli Ballazhi” cikli i ulët nga klasa e parë deri në klasë të pestë potencohet se nuk kemi mungesa. Kërkoj ta dijë se a e kanë vazhduar edhe javë e mbetur apo ku është problemi?

Hanumshahe Dibrani thekson:- a keni ndonjë informacion për çerdhen se a do të hapet në këtë vit?

Menduh Vlashi thekson:- sa i përket numrit të mungesave nuk janë të sakta për shkak se diku i qesin diku jo për shkak se na shënimet i marrim prej drejtorëve të shkollave. Disa shkolla i kanë shënuar edhe orët e humbura të grevës e disa nuk i kanë shënuar dhe te shkolla fillore për mungesat i bien as dy orë të humbura për kokë të nxënësit. Sa i përket gjendjes momentale të objekteve do ta kemi një informatë për fillimin e vitit të ri shkollorë në muajin shtator dhe do ta paraqes gjendjen. Mungesat e arsimtarëve janë të shënuara në tabelarë. Sa i përket trajnimeve për mësimdhënës po shpresojmë që me Ministrinë e Arsimit në qeverinë e ardhshme do të jetë bashkëpunimi më i madh për shkak se nuk kemi pasur bashkëpunim të mirë edhe pse është premtuar që do të vazhdojnë me trajnime. Për mësim gjithëditore dy shkolla në Prishtinë e kanë pasur si pilot projekt por sipas informacioneve që kam gati ka dështuar dhe nëse fillojnë nëse na kërkohet nga niveli qendrorë do të fillojmë me shkollën fillore “Kështjella e Diturisë” dhe me shkollën fillore “Veli Ballazhi”. Sa i përket shkollës së fshatit Seçishtë unë kam biseduar me Kryetarin, Kryesuesin e Kuvendit se kemi probleme me shkollën në fshatin

Seçishtë dhe Krivenik dhe do të njoftoj në muajin shtator për këtë çështje dhe do të kërkoj nga kryetari i komunës që ta diskutojmë si pikë të veçantë. Sa i përket suksesit të nxënësve unë nuk kam qenë i kënaqur edhe kur kam qenë drejtorë, të kënaqur nuk mund të jemi me suksesin që e kemi arritur por nuk mund të themi që jemi keq për shkak se në garat të cilat janë mbajtur i kemi katër vende të dyta në nivel të Republikës së Kosovës. Suksesi që paraqitet në tabelarë për mua është numër dhe suksesi më i madh për mua është kur studentët regjistrohen nëpër fakultete. Sa i përket çerdhes deri tash nuk kemi buxhet dhe nëse niveli qendrorë dedikon buxhet shtesë çerdhja është e gatshme me filluar.

Florim Shkreta thekson:- fusha e futbollit që është duke u ndërtuar afër çerdhes nuk më duket që është mirë.

Menduh Vlasi thekson:- e kemi biseduar këtë çështje por nuk kemi hapësirë tjetër dhe shkolla e mesme nuk ka fushë të sportit dhe këtë do ta shfrytëzon edhe rinia.

Akif Shkreta thekson:- në testin e maturës në shkollë të mesme administruesit e testit veprojnë sipas rregullave dhe detyrave të tyre dhe nxënësit tanë konkurojnë për me u regjistruar në fakultet të mjekësisë dëmtohen për shkak të pikëve të ulëta. Në disa komuna të tjera administruesit e testit kanë harmoni me nxënësit dhe iu tregojnë dhe dalin të suksesshëm në ato pikë të grumbulluara dhe ato pikë e përcaktojnë se a regjistrohet studenti apo jo. Unë mendoj që nuk është në rregull nëse në një komunë iu tregojnë e në tjetrën jo për shkak se pëson studenti.

Mefail Suma thekson:- u potencua që administruesit e testit iu tregojnë nxënësve por unë mendojë që drejtpërdrejtë mesazhet ju shkojnë nxënësve prej drejtorëve të shkollave.

Florim Shkreta thekson:- z.Akif Shkreta i them që me ia ndërruar fjalëve vendin për shkak se në Han të Elezit iu ndihmojnë dhe për mendimin tim është keq për shkak se nxënësin duhet me përgatitur me kohë e me i ndihmuar në test dhe pastaj për me u regjistruar ka probleme.

Isni Bushi thekson:- nuk po flas për vitet e kaluara por në këtë vit administrimi ka qenë korrekt shumë sepse nuk ka mundur askush me i treguar dikujt.

Menduh Vlasi thekson:- edhe nëse i tregohet në test por fakultet publike kanë testin e vetë dhe nëse studenti nuk arrin me kaluar prapun nuk ia marrin parasysh pikët e testit të maturës. Në këtë vit shumica e fakulteteve nuk janë plotësuar me studentë të cilët e kalojnë prapun dhe kanë vende të lira.

Teuta Shkreta thekson:- sa i përket testit të cilin e kalojnë çdoherë profesorët kanë treguar, mirëpo a duhet me ju treguar të ju tregohet të gjithëve e jo dikujt po e dikujt jo për shkak se po vërehen gjërat.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

8. Informatë mbi raportin e shpenzimeve për "Javën Kulturore" 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

9. Informatë për korrje shirjet.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- në krahasim me vitet e tjera është shqetësuese me dalë me dy hektarë të mbjellur me grurë , mirëpo shqetësuese ka qenë edhe çështja e kombajit. Subvencione kemi dhënë për hektarë. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Sabrije Krasniçi thekson:- a është mungesë e ujit që nuk mbjellët gruri apo është mungesë e kombajit?

Zaim Bela thekson:- nuk mendoj që është problem çështja e ujit për shkak se drithërat e bardha bëhen në pranverën e hershme por edhe leverdinë qytetarët nuk po e shohin.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

10. Informatë mbi raportin financiar për gjashtëmuajorin e N.P.L “Pastrimi” sh.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Kujtim Dernjani thekson:- Ndërmarrja Publike Lokale – N.P.L “Pastrimi” Sh.a, bënë menaxhimin e mbeturinave në komunën e Hanit të Elezit dhe gjithsej ka dymbëdhjetë (12) punëtorë, katër prej të cilëve, Bedri Bushi me numër personal 1012244564 në pozitën e punës (Shofer), Sevdil Shkreta me numër personal 2173308577 punëtorë (Punë Publike), Alban Hasallari me numër personal 1247744122 punëtorë (Punë Publike), Besmir Hasallari me numër personal 1234149110 punëtorë (Punë Publike), janë me kontratë në vepër, gjashtë (6) muaj i paguan Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, prej datës 01.03.2019 deri më 31.08.2019 dhe kontrata iu skadon në fund të muajit Gusht, ndërsa punëtorin Bedri Bushi, me 100€ bruto në muaj kontribon, NPL “Pastrimi” Sh.a. z.Nusret Bushi – Kryeshef Ekzekutiv i NPL “Pastrimi”, në muajin Janar 2019-të, paraqet dorëheqjen e tij, si Kryeshef Ekzekutiv te Bordi i Drejtorëve të NPL-së, i lartpërmenduri në bazë të evidencës që posedon NPL “Pastrimi”, ka qenë në marrëdhënie pune nga data 01.01.2017, dhe zyrtarisht mardhënia e tij e punës përfundon me datë 31.01.2019. Në muajin Shkurt me datë 01.02.2019, merret vendim për emërimin e ushtruesit të detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv, nëpunësi z.Samir Shkreta, i radhitur ne vendin e punës si “Sekretar i NPL-së”, i emëruari fillon punën si Kryeshef Ekzekutiv me datë 01.02.2019, deri në rizgjedhjen e kryeshefit të ri. Në muajin Shkurt me datë 05.02.2019 deri më 19.02.2019, ka qenë një konkurs i hapur për Kryeshef Ekzekutiv i NPL “Pastrimi” Sha – Hani i Elezit. Në muajin Prill me datë 01.04.2019, emërohet Kryeshef Ekzekutiv i NPL “Pastrimi” Sha, z.Irfan Suma, dhe mandati i tij është tre (3) vite. Në muajin Qershor, Komuna e Hanit të Elezit, përfiton donacion një kamion të mbeturinave ISUZU, donacion ky nga Qeveria Japoneze, vlera e tij është 61.016.94 euro, mjete këto që sipas marrëveshjes së nënshkruar në Mars të këtij viti, do të shfrytëzohen për blerjen e një kamioni të ri për mbeturina, e cila do të shfrytëzohet nga Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave NPL “Pastrimi” Sh.a, në Komunën e Hanit të Elezit. Kontratat familjare dhe bizneseve për vitin 2019-të janë:- Janar 14 kontrata, Shkurt 40 kontrata, Mars 6 kontrata, Prill 5 kontrata, Maj 4 kontrata, Qershor 5 kontrata gjithsej Janar – Qershor 74 kontrata familjare, ndërsa ato bizneseve Janar – Qershor, janë bërë 10 kontrata. Të hyrat janë në shumë 41, 376.66 €, kurse totali i shpenzimeve është në shumë prej 38,367.03 €. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- sa anëtarë të komisionit ka kjo ndërmarrje? Sa anëtarë të bordit i ka dhe sa punëtorë i ka ndërmarrja?

Kujtim Dernjani thekson:- kompania gjithsej i ka dymbëdhjetë punëtorë dhe prej tyre katër i ka me kontratë në vepër, kurse tetë punëtorë i ka të rregullt. Katër anëtarë të bordit të drejtorëve dhe një kryeshef ekzekutiv dhe tre anëtarë të komisionit të aksionarëve.

Sabedin Hasallari thekson:- në bazë të informacioneve që i kemi ndërmarrja në këtë gjashtëmujorë nuk ka performuar në mënyrë të kënaqshme për shkak se të hyrat dhe shpenzimet thuhet janë të barabarta. Kërkoj informacion për numrin e ekonomive familjare dhe i bizneseve të cilat paguajnë dhe i atyre që nuk paguajnë në tërë teritorin e Hanit të Elezit. A është bërë identifikimi i ndonjë vendi për hedhjen e mbeturinave të ngurta ku qytetarët do ta kenë një pikë për me i hedhur mbeturinat. Për personat të cilët janë dërguar në përmbarues dhe kanë filluar me paguar dhe kam parashtruar kërkesë që atyre duhet të iu falet diçka për shkak se ata po dëmtohen dy herë, kurse ata të cilët nuk kanë bërë kontrata diku po i hedhin mbeturinat. Cilat kategori janë të liruara nga pagesa e mbeturinave?

Kujtim Dernjani thekson:- nëse krahasohen me vitin e kaluar 1243.50 € jemi në plus dhe vitin e kaluar nuk kemi pasur kontratë me kompaninë “Sharrcem” , dogana, polica dhe terminali doganorë por të gjitha kanë lidhur kontratë. Me vendim të kuvendit nuk kemi deponi për hedhjen e mbeturinave të ngurta por ata të cilët kanë nevojë për me i hedhur mbeturinat e këtij llojit komuna i njofton për vendin se ku do të hedhen. Nuk kemi bërë ndonjë plan se cilat kategori do të lirohen prej pagesës. Sa i përket personave të cilët janë dërguar në përmbarues unë pyetjen ua kam dërguar Bordit të Drejtorëve dhe kanë potencuar se nuk mundën me u liruar prej pagesës për shkak se përmbaruesi i ka procedurat e veta.

Florim Shkreta thekson:- për me u bërë një parregullsi ndaj qytetarëve të cilët e mbështetin rregulloren e juve është bërë dhe një prej atyre jam edhe unë për shkak se një pjesë e madhe të cilët nuk kanë nënshkruar kontratë kanë dalë përfitues , ndërsa qytetarët të cilët kanë dashur me i zbatuar urdhrat e kompanisë kanë nënshkruar kontratë dhe i kanë dërguar në përmbarues pa paralajmërim. Për 45 € është ndëshkuar qytetari me dënim mbi 300 €. Për hedhjen e mbeturinave të ngurta është mirë me i njoftuar qytetarët për shkak se në fshatin Seçishtë po i hedhin mbeturinat e ngurta ilegalisht.

Hanumshahe Dibrani thekson:- kërkoj që kontinierët e dëmtuar të zëvendësohen me kontinier të ri.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

11. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Florim Shkreta thekson:- përgjigje nuk më është dhënë për pronën që është shpronësuar afër objektit të komunës dhe është mirë për mbledhjen e radhës me dhënë përgjigje. Përgjigja që është dhënë nga Drejtoria për Shërbime Publike nuk është dhënë e saktë se çka kam kërkuar unë për shkak se përgjigje më është dhënë një kontratë me KEDS-in të cilën e ka bërë kompania “Elektra” për shtrirjen e rrjetit kabllorë por unë kam kërkuar për rrjetin kabllorë të cilin e ka shtrirë nëpër Han të Elezit që përcaktohet për metër gjatësi në zonat rurale dhe urbane se a paguan taksë ndaj komunës. Drejtoria ka dhënë përgjigje për KEDS-in dhe përsëri e kërkojë këtë përgjigje. Përgjigje me shkrim nuk më është dhënë për pyetjen të cilën e kam parashtruar në mbledhjen e kaluar për punëtorin më të dalluar.

Mefail Suma thekson:- te rreth rrotullimi është mirë me mbjell lule dhe gjelbërim por edhe komuna ta mirëmban atë pjesë aty sepse është hyrje dhe dalje e Hanit të Elezit.

Teuta Shkreta thekson:- te rreth rrotullimi po rrinë shumë qenë endacak dhe fëmijët do ta kenë pak problem kur të fillon shkolla. I propozoj Drejtorisë së Bujqësisë që të çelet një minikioskë për prodhimet vendore për shkak se ata po shesin në rrugë dhe është mirë që edhe ata si shitës dhe ne si blerës e kemi më të lehtë nëse janë të grumbulluar me një vend.

Kujtim Dernjani thekson:- tjetër përgjigje nuk mundet me të dhënë Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë sepse nuk mundemi me detyruar dikend me paguar taksë kur nuk ta shfrytëzon pronën tënde për shkak se kompania është duke e shfrytëzuar shtyllat dhe pronën e KEDS-it.

Florim Shkreta thekson:- unë e shohë që kompania e ka mashtuar komunën për shkak se rregullorja e përcakton këtë lloj takse dhe unë kërkoj përsëri përgjigje me shkrim për këtë çështje.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:44

Procesmbajtësi
Ayni Bushi

